



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.6.2023

Nr: 648

Ora: 09:30

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË KRUIË, QARKU DURRËS, Z. ARTUR XHEKE BUSHI, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 2.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Krujë, Qarku Durrës, z. Artur Xheke Bushi, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 20, me vendimin nr. 292, datë 18.5.2023, ka shpallur fitues z. Artur Xheke Bushi, si Kryetar i Bashkisë Krujë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Data: 2.6.2023 Nr: 648
Ora: 09:30



“Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Krujë, Qarku Durrës, z. Artur Xheke Bushi, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Kundër këtij vendimi është administruar kërkesa ankimore nr. 82, datë 23.5.2023, me ankues koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 292, datë 18.5.2023 të KZAZ nr. 20, për Këshillin Bashkiak Krujë, si dhe kundërshtimin e vendimit nr. 293, datë 18.5.2023, të KZAZ nr. 20, për Kryetarin Bashkisë Krujë, duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në disa QV, ku janë konstatuar prania e komisionerëve në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Më datë 26.5.2023, në seancë publike Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve shqyrtoi kërkesën ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 82, datë 23.5.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Lënien në fuqi të vendimeve nr. 292 dhe nr. 293, datë 18.5.2023, të KZAZ nr. 20, Bashkia Krujë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Krujë, Qarku Durrës, z. Artur Xheke Bushi, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI